



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2158/2 prot.,

Datë 06.09.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AA&P” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-76344-07-29-2023, me objekt: “Blerje shtylla druri dhe betonarme”, me fond limit 28,405,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Shkodër
- Ankimues:** “AA&P” SHPK me NIPT L61713009Q dhe adresë: Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Tanush Frasheri , Mbrapa Shkolles Mysine Kokalari , Pallati B&K
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria Rajonale e OSSH Shkodër me adresë: Rr. Daut Borici, Perash, Shkodër

Në datën 04.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3391 dhe me nr. 2158/2023 prot., datë 04.09.2023 e operatorit ekonomik “AA&P” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AA&P” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti

*kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “AA&P” SHPK.*

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*“1. Per shtyllat e betonit eshte dhene autorizim nga kompania Tehno Burimi. Ne autorizimin perkates eshte percaktuar se per kete procedure nuk eshte e autorizuar ansnje kompani tjeter per te ofertuar mallrat e prodhuara nga kjo kompani, pervec subjektit AA&P. Nderkohe qe po per kete procedure prokurimi eshte autorizuar edhe kompania Luars Bros e cila rezulton te kete ofertuar ne procedure.*

*2. Autorizimi i dhene nga kompania tehno Burimi per shtyllat e Betonit me Permasa 9/6 dhe 12/10 nuk perputhen me permasat e kerkuara nga ana jone ne specifikemet teknike.”*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.09.2023

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Fiorent Zguro**